



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## PLATFORMA E PARTNERITETIT PER INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBETARE PER INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 23 – Mbrojtja e fëmijëve online nga çdo lloj forme dhune dhe abuzimi  
28 mars 2024, Tiranë

### REKOMANDIME

*Të drejtat e fëmijëve janë pjesë e të drejtave themelore të njeriut dhe përfshihen në Kapitullin 23 të Acquis së BE- Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore. Sipas të dhënave sot në botë, 1 në 3 përdorues të internetit është fëmijë ndërkohë që rreth 40% e fëmijëve kanë hasur të paktën një formë të dhunës apo abuzimit online (bullizimi kibernetik, ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, fake news, abuzimi seksual online etj.) Kjo tregon që mbrojtja e fëmijëve në botën dixhitale është sfiduese, duke qenë që kjo është një fushë që së fundmi ka marrë një zhvillim të madhedhe ndër të tjera një fushë shumë dinamike ku ka zhvillime të shpeshta dhe të shpejta. Në këtë drejtim edhe bërja e politikave dhe marrja e masave për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimet dhe rreziku online, si dhe informimi dhe ndërgjegjësimi për parandalimin duhet të realizohen në të njëjtën shpejtësi dhe të përditësohen sipas nevojave dhe ndryshimeve që vijnë në këtë fushë.*

### Kuadri ligjor dhe administrativ në Shqipëri

- Rekomandohet një kuadër ligjor për median online ku një fokus të veçantë duhet të ketë mbrojtja e fëmijëve në botën dixhitale nga abuzimet apo rreziqe të tjera. Kodi Penal gjithashtu që po hartohet duhet të ketë në vëmendje vendosjen e praktikave abuzuese apo kriminale online si veprime të dënueshme duke përcaktuar dhe dënimet përkatëse. Një shembull nga Sllovakia, është që ngacmuesi apo abuzuesi që mund të dënohet dhe mban përgjegjësi për veprat penale mund të jetë si person fizik, ashtu dhe person juridik.
- Rekomandohet që strukturat përgjegjëse por dhe aktorët politikëbërës, të jenë të gatshëm të bëjnë ndryshimet dhe përditësimet e nevojshme në kuadrin ligjor, sa herë që ka zhvillime dhe risi në median online dhe botën dixhitale. Si një fushë që zhvillohet shumë shpejt, edhe

*\* Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 23 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian".*

*\*Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



rreziqet që mund të vijnë gjithashtu janë të shpejta dhe shpeshherë të panjohura. Për këtë rekomandohet një monitorim i këtyre zhvillimeve dhe përgjigje e menjëhershme sa herë që lind nevoja. Ndarja e eksperiencave me shtetet e tjera europiane shihet si një mundësi e mirë për të qenë gjithmonë të përditësuar mbi këto problematika dhe zgjidhjet që mund të ofrohen në mënyrë të shpejtë dhe cilësore.

- Një tjetër element për tu marrë në konsideratë është dhe kategorimi i rrezikshmërisë që kanë përmbajtjet në media online, të cilat në bazë të klasifikimit të tyre dhe masat dhe sanksionet e marra duhet të variojnë (si ndalim i plotë i përmbajtjes, ose përshtatja e tij dhe filtrimi për një audiencë specifike) duke vendosur klauzola sigurie duke pasur në vëmendje interesin dhe mbrojtjen e fëmijës.
- Rekomandohet hartimi i një Kodi të integruar dhe të standardizuar të Etikës për median online, me pika të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve online për mediat online sa i përket përmbajtjes që ato ofrojnë dhe audiencës që targetojnë.
- Një eksperiencë pozitive nga Sllovakia është realizimi i raporteve të monitorimit mbi të drejtat e fëmijëve që realizohen në mënyrë periodike nga institucionet përgjegjëse. Këto raporte ndihmojnë për të kuptuar situatën e mbrojtjes së fëmijëve, problematikat kryesore dhe janë orientuese për masat që duhet të ndërmerren në të ardhmen. Ato duhet të përmbajnë dhe të dhëna dhe statistika të nevojshme për të konkretizuar çështjet që monitorohen. Këto raporte monitoruese mund të realizohen dhe në bashkëpunim apo me kontributin e aktorëve të shoqërisë civile që janë të përfshirë në këto fusha.
- Në përditësimin e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve online, sugjerohet që masat e marra të mos mjaftohen vetëm me përmbushjen e detyrimeve që vijnë nga BE apo instrumentet ndërkombëtare (pra minimumi i përafërimit me legjislacionin europian) por të përshtaten dhe me nevojat dhe problematikat specifike që mund të jenë në vend, duke synuar që ti përgjigjen më mirë këtyre problematikave dhe të ofrojnë zgjidhje të përshtatura me realitetin në Shqipëri.

*\* Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 23 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian".*

*\*Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



- Eksperiencë pozitive nga Sllovakia është dhe ngritja e një platforme monitorimi por dhe ankesash sa i përket përmbajtjeve dhe mesazheve që vijnë në mediat audiovizive dhe atyre online, dhe që mund të cenojnë fëmijët. Sllovakia ka një Këshill të Medias Audiovizive dhe asaj Online që monitoron dhe merr vendime për përmbajtjen mediatike në rast ankesash dhe kërkesash nga qytetarët. Në Shqipëri mungon një autoritet i tillë për median online.
- Rekomandohet krijimi apo ngritja e një grupi pune ndërinstytucional, puna e të cilit të lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e të miturve në hapësirën dixhitale, që do të shërbejë për koordinimin e politikave dhe masave konkrete, por dhe ti monitorojë ato dhe të bëjë vlerësimet përkatëse sa i përket efikasitetit dhe impaktit të tyre.

### **Informimi dhe ndërgjegjësimi**

- Për parandalimin e rrezikut dhe cenimit të fëmijëve online, rekomandohet informimi dhe edukimi i tyre mbi sigurinë dixhitale dhe si të mbrohen në raste rreziku. Kjo mund të realizohet në bashkëpunim me disa aktorë: Edukimi në shkolla me fushata ndërgjegjësuëse dhe aktiviteteve jo vetëm për nxënësit, por dhe stafin e mësimdhënësve dhe prindërit.
- Sugjerohet që për të informuar dhe edukuar fëmijët dhe të rinjtë është i nevojshëm një qasje më inovatore, e qartë por tërheqëse për ta, realizuar posaçërisht për këto grupmosha dhe për të nxitur interesin e tyre për tu përfshirë në këto fushata informimi dhe për ti kuptuar ato. Një praktikë pozitive është dhe përfshirja drejtpërdrejt e fëmijëve në realizimin e këtyre aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjësuëse, për të pasur rol aktiv dhe jo thjesht si përthithës të këtyre informacioneve.
- Rekomandohet përgatitja e një udhëzuesi apo liste rregullash praktike dhe orientuese sa i përket përdorimit të sigurt të mediave online dhe internetit, ku të targetohen jo vetëm të miturit si përdorues të tyre, por dhe aktorët e tjerë: prindërit, mësimdhënësit, ofruesit e shërbimeve të medias online, aktorët e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore duke përcaktuar rolin e tyre, përgjegjësinë dhe masat që mund të marrin për parandalimin e rreziqeve online apo promovimin e mbrojtjes së fëmijëve në botën dixhitale.

*\* Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 23 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian".*

*\*Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## Roli i Shoqërisë Civile dhe grupeve të interesit

- Për këtë fushë dinamike dhe me ndjeshmëri të lartë rekomandohet një qasje sa më bashkëpunuese e institucioneve shtetërore me aktorët e tjerë të përfshirë, duke qenë që përfshin disa aktorë dhe grupe interesi. Sugjerohet ndër të tjera një bashkëpunim i ngushtë dhe rol shumë aktiv mes institucioneve shtetërore dhe ofruesve të medias apo shërbimit të internetit, të cilët duhet të përfshihen në kontrollimin dhe filtrimin e përmbajtjes që ata lejojnë duke pasur filtrat dhe klauzolat e nevojshme të sigurisë. Gjithashtu në raste të ankesave të jenë bashkëpunues në gjetjen e zgjidhjeve dhe marrjen e masave të nevojshme.
- Shoqëria Civile rekomandohet të luajë rolin monitorues dhe kontrollues sidomos të përmbajtjeve online dhe të medias online. Në Shqipëri mungon një ligj i dedikuar për median online si dhe një institucion (*watchdog*) për monitorimin e saj. Në këtë aspekt në bashkëpunim me Shoqërinë Civile mund të bëhet e mundur që media online të monitorohet në mënyrë më proaktive nga ato organizata të shoqërisë civile për të parandaluar çdo përmbajtje që mund të jetë e papërshtatshme apo e rrezikshme për të miturit në Shqipëri.

*\* Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 23 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian".*

*\*Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*